



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 458/1 Prot.

Shkodër, më 21/07 / 2025

VENDIM

Nr. 11, Datë 16.07.2025

“PËR DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2025”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e Datës 16.07.2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër **“Për disa ndryshime në strukturën organizative, të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025”**, bazuar në: Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 **“Për vetëqeverisjen vendore”**, përkatësisht në Nenin 8, pika 2) dhe Nenin 77, gërma ç); Ligjin Nr. 152/2013 **“Për Nëpunësin Civil”** (i ndryshuar); nenin 15 të Ligjit nr.115/2024 **“Për buxhetin e vitit 2025”** VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 **“Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”**, i ndryshuar me VKM nr.503, datë 01.08.2024, VKQ nr.27, datë 20.12.2024 dhe VKQ nr.05, datë 13.03.2025, të Ligjit Nr. 8752, datë 26.3.2001, **“Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore”**, i ndryshuar, si dhe të kreut IV, të VKM-së Nr.80, datë 28.1.2005, **“Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”**, Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **17 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota Abstenim**,

VENDOSI:

1. Miratimin e krijimit të strukturës dhe pagave të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës, brënda numrit të punonjësve të miratuar në organikë, të përbërë nga 3(tre) punonjës.
2. Struktura organizative e punonjësve të Këshillit të Qarkut për vitin 2025, do të jetë sipas tabelës bashkangjitur.

për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.



4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Edmond NDOU

